BASHKIA
KORÇË

ROMACTED
Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor



# PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

Bashkia Korçë


MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
IRCA
INSTITUTE OF ROMANI CULTURE IN ALBANIA

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

BASHKIA
KORÇË

ROMACTED
Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor

# PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

# BASHKIA KORÇË

**Programi ROMACTED**

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

**Një program i përbashkët i**
**Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

**Koordinatorë vendorë, Bashkia Korçë:**
Benila Themeli, Nënkryetare e Bashkisë
Ilir Zguri, Drejtor i Kujdesit Social

**Ekspertë:**
Elona Dhembo
Raimonda Duka
Alketa Zallemi
Danjel Hyseni
Xhesika Korra

**Redaktor:**
Orsiola Kurti

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Të gjitha palët që janë të interesuara për ta riprodhuar apo përkthyer të plotë apo pjesërisht këtë dokument, inkurajohen ta bëjnë diçka të tillë me autorizimin paraprak të Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Dizajni dhe printimi:  Gent Grafik

Publikuar prej Programit ROMACTED
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës
Kati i tretë, Tiranë, Shqipëri
www.coe-romacted.org

www.coe.al
www.ec.europa.eu

© Programi ROMACTED, Dhjetor 2020



# Falënderime

Bashkia Korçë është e vendosur në rrugën e saj për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Si qendër e një poli rajonal me rëndësi kombëtare ajo punon për zhvillimin harmonik të të gjitha njësive të saj ashtu si edhe të të gjitha grupeve dhe komuniteteve. Kjo frymë dhe ky vizion i Bashkisë Korçë po konkretizohet përmes përpjekjeve të vazhdueshme, qoftë në planin e hartimit të politikave dhe planeve vendore, ashtu edhe në zbatimin dhe monitorimin e tyre përmes masave dhe aktiviteteve specifike. Pjesë e këtyre përpjekjeve është edhe hartimi i Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, i paraqitur në këtë dokument.

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 është një dokument shumë i rëndësishëm për Bashkinë Korçë si dhe një instrument i pazëvendësueshëm në rrugën e përfshirjes dhe integrimit të pakicave në bashkinë tonë. Vlera e shtuar e tij qëndron në procesin dhe metodologjinë e ndjekur për hartimin e planit ku përqasja gjithëpërfshirëse, me pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe në çdo hap të procesit të aktorëve përgjegjës dhe veçanërisht të aktivistëve, organizatave dhe qytetarëve romë dhe egjiptianë, pjesë e Grupit Komunitar të Veprimit, e bën këtë dokument një instument të rëndësishëm zhvillimi, por dhe përgjigjshmërie të pushtetit vendor ndaj qytetarëve.

Gjej rastin që të falenderoj përzemërsisht punën e palodhur të stafit të Bashkisë Korçë, organizatave vendore të shoqërisë civile, grupeve komunitare, mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës "ROMACTED: Promovimi i Qeverisjes së Mirë dhe Fuqizimit Rom në Nivelin Vendor", si dhe çdo qytetar që aktivisht u bë pjesë e procesit.

Duke shresuar se çdo aktor do të marrë përsipër përgjegjësitë që rrjedhin nga ky dokument dhe se vullneti për zbatimin e tij nuk do të mungojë në asnjë moment, uroj që zbatimi i tij të sjellë rezultatet e dëshiruara për pakicat e synuara drejt aktualizimit të vizionit të përbashkët:

> ***Bashkia Korçë ofron mundësi të barabarta për qytetarët e saj, pavarësisht përkatësisë etnike, dhe punon për nxitjen e gjithëpërfshirjes, multikulturalizmit dhe integrimin me të drejta të plota e të barabarta të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, drejt një integrimi të plotë ekomonik, social, kulturor dhe politik, në respekt të tipareve të veçanta dhe ruajtjes së identitetit kulturor.***

Sinqerisht,

**Sotiraq FILO**
Kryetar i Bashkisë Korçë

# Pasqyra e Lëndës


**FALËNDERIME** 5

**I. HYRJE** 9

**II. KUADRI LIGJOR DHE POLITIK** 11

**III. METODOLOGJIA DHE PROCESI** 14

**IV. PROFILI I BASHKISË KORÇË** 19

**V. PAKICAT ROME DHE EGJIPTIANE NË BASHKINË KORÇË DHE VLERËSIMI I NEVOJAVE** 21

- V.1 ARSIMI 22
- V.2 PUNËSIMI DHE SIGURIA EKONOMIKE 23
- V.3 STREHIMI 25
- V.4 SHËNDETI 26
- V.5 ÇËSHTJE TË TJERA 27

**VI. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR** 28

- VI.1 VIZIONI 28
- VI.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË 28

**VII. PLANI I MASAVE** 29

**VIII. BURIMET FINANCIARE** 44

**VIII. MONITORIMI DHE VLERËSIMI** 48

**IX. SHTOJCA** 51

- IX.1 METODA DHE TEKNIKA PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PARËSORE ME PJESËMARRJEN E KOMUNITETIT 51
- IX.2 PYETËSORI PËR VLERËSIMIN E KAPACITETEVE TË BASHKISË 55
- IX.3 GRUPI INSTITUCIONAL I PUNËS, BASHKIA KORÇË 62
- IX.4 VENDIM I KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË 63

# I. Hyrje

Qeverisja e mirë dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm janë në themel të asaj çka qeverisja në çdo nivel duhet të sigurojë për qytetarët. Kjo është veçanërisht sfiduese në nivel vendor ku problematikat e decentralizimit dhe reformimit i janë shtuar atyre të mëhershme. Për këtë nevojitet, ndër të tjera, një përmirësim i vazhdueshëm i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore, forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendim-marrëse si dhe monitorimi i zbatimit të politikave dhe programeve në nivel vendor mbi bazën e parimit të mosdiskriminimit dhe angazhimit qytetar.

Një instrument i rëndësishëm që e mundëson mirëqeverisjen në nivel vendor janë planet vendore të zhvillimit. Ato përdoren nga bashkitë për të përmirësuar aspekte të qeverisjes vendore në kuadër të zbatimit të politikave të zhvillimit bazuar në vlerësimin e nevojave duke mundësuar shpërndarjen e prioritizuar të burimeve të vlefshme, lejon identifikimin e hendekut financiar për të negociuar me aktorë të tjerë dhe agjenci donatore në mbështetje të projekteve të zhvillimit në nivel vendor, si dhe mundëson monitorimin e rregullt të zbatimit të masave dhe aktiviteteve.

Ky dokument paraqet Planin Vendor të Bashkisë Korçë për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane, një instrument që do të garantojë që parimet e mirëqeverisjes do të zbatohen dhe mundësojnë integrimin dhe gjithëpërfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane në këtë bashki për periudhën 2019-2022. Ky plan vjen si një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, si dhe në linjë me Planin Social 2019-2022 të miratuar nga Bashkia Korçë.

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, udhëhiqet nga disa parime themelore si: (i) nxitja e përfshirjes sociale, (ii) reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome

dhe egjiptiane, (iii) respektimit të dallimeve midis pakicave rome dhe egjiptiane, (iv) përfshirjen e pakicave në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave, (v) forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërise civile, aktivistëve dhe grupeve komunitare. Në vijim paraqiten kuadri ligjor dhe politik në të cilin operon ky plan, metodologjia ndjekur për hartimin e tij, si dhe nevojat e vlerësuara dhe masat e parashikuara sipas fushave prioritare: arsimi, punësimi dhe siguria ekonomike, strehimi, shëndeti dhe çështje të tjera të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale e shanseve të barabarta.

# II. Kuadri ligjor dhe politik

Në Shqipëri, kuadri ligjor që garanton respektimin e të drejtave të pakicave ka themelet e tij në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për të vazhduar me konventat ndërkombëtare dhe ligje, ku ndër të tjera përfshihen: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Kombet e Bashkuara, 1948[1] ), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), të ratifikuar në vitin 1991, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1976 (1991), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare [2], Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980 (1996), Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia (nr.168 të ILO-s), 1988 (2006), Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960), Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (ligji nr. 10071/2009), etj.

Me miratimin dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare, pas viteve '90 qeveritë shqiptare kanë hartuar dhe miratuar ligje (dhe akte nën-ligjore) si dhe politika të tjera[3] të cilat kanë krijuar premisat për një mjedis më mundësues për integrimin e pakicave në vend. Nga ana tjetër, edhe procesi i integrimit evropian i cili nuk përfaqëson vetëm një mundësi për vendin, por edhe një sfidë për sa i përket realizimit të reformave strukturore drejt statusit shtet anëtar i Bashkimit Evropian, ndikon në shtyrjen përpara edhe të proceseve integruese për pakicat.

Ndër dokumentet më të rëndësishëm në nivel kombëtar janë:

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim** (SKZHI) 2015-2020 dhe politikat sektoriale "Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), Strategjia për Mbrojtjen Sociale janë fokusuar në (i) *përmirësimin e përfshirjes sociale dhe aksesit në shërbimet bazë* për personat dhe grupet e margjinalizuara,

---

1 Miratuar ne vitin 1955

2 Ligji Nr. 8496 / 1999

3 Ligje specifike të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt apo indirekt përfshijnë: ligji "Për avokatin e popullit" (8454/1999), ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (9887/2008), ligji "Për barazinë gjinore" (9970/2008), Kodi zgjedhor (2008), ligji "Për ndihmën juridike" (10039/2008), ligji "Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit" (2010), ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve", i ndryshuar (Ligji Nr. 96/2017), VKM-ja "Për arsimimin e komuniteteve minoritare në gjuhën e tyre amtare", i ndryshuar, ligji për strehimin social (Ligji nr.22/2018), etj. Po kështu një sërë vendimesh të KM dhe dokumentesh politikë në këtë kuadër përfshijnë: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet", i ndryshuar (VKM 726/12 Dhjetor 2018), Plani Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, i ndryshuar, Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom, Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) dhe Dekada e Përfshirjes së Romëve, 2010 – 2015, PKV për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 2016-2020.

(ii) *ofrimin e programeve të specializuara, që lehtësojnë aksesin në tregun* e punës dhe rrisin mundësitë e punësimit, (iii) *ofrimin e mundësive për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm* për personat, që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe që nuk e kanë përfunduar atë, (iv) *Shtrirja e shërbimeve psiko*logjike, veçanërisht në shkollat ku ka fëmijë romë dhe egjiptianë dhe nxënës, që rrezikojnë të braktisin shkollën, (v) *Lehtësimi i aksesit të grupeve në nevojë në shërbimet shëndetësore* përmes sigurimit të shërbimeve të shëndetit publik, ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik dhe i paketave të informacionit, si dhe i programeve specifike për aksesin në sistemin shëndetësor, ofrimi i mbështetjes nga punonjësit socialë dhe shërbimet e duhura shëndetësore, (vi) *Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimit në nivel rajonal/vendor,* sipas standardeve të kujdesit për të gjitha grupet në nevojë nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave kombëtarë dhe vendorë për identifikimin dhe vlerësimin e nevojës për shërbimet e kujdesit social në përputhje me procedurat standarde të veprimit dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat ndërkombëtare.

Masat e **Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve** (2016-2020) janë projektuar në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët, dhe politikat antidiskriminuese është një nga pesë prioritetet kyçe të agjendës për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Parimet kryesore të PKV-së për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve përfshijnë: (i) nxitja e përfshirjes sociale, (ii) masat për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës, (iii) respektimi i dallimeve midis/dhe brenda këtyre komuniteteve, (iv) garantimi i përfshirjes së këtyre komuniteteve në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, (v) nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve (qeverisja qendrore/ dhe njësitë e qeverisjes vendore, OSHC-të dhe komunitetet).

**Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore** (2015-2020), Reforma Territoriale Administrative (2015), Ligji për vetëqeverisjen vendore[4], Ligji për financat publike vendore[5] krijuan bazën dhe hapësirën për reformimin e mëtejshëm të njësive të qeverisjes vendore dhe riorganizimin administrativ të bashkive mbi bazën e ndarjes së re territorale. Synimet strategjike janë të lidhur me: (i) rritjen e eficiencës së strukturave të qeverisjes vendore, (ii) forcimi i financave vendore dhe decentralizimi fiskal, (iii) zhvillimi ekonomik vendor i qëndrueshëm dhe (iv) qeverisja e mirë në nivel

4 Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore
5 Ligji 68/2017 Për Financat Vendore

vendor. Ligje të tjera të rëndësishme janë edhe Ligji 119/2014 Për të Drejtën e Informimit dhe Ligji 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Në Shqipëri, qeverisja e mirë ka të bëjë me zhvillimin e përgjegjshëm të çështjeve publike dhe menaxhimin e burimeve publike, të cilat janë përfshirë në 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë[6] të Këshillit të Evropës. Këto 12 parime janë të përfshira në Strategjinë për Inovacionin dhe Qeverisjen e Mirë, miratuar me vendim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2008. Ato mbulojnë çështje të tilla si sjellja etike, sundimi i ligjit, efikasiteti dhe efektiviteti, transparenca, menaxhimi i shëndoshë financiar dhe llogaridhënia.

Në Shqipëri, aktivitetet e Këshillit të Evropës[7] përqendrohen kryesisht në trajtimin e pengesave që mbajnë në vend të drejtat e pakicave, kryen monitorime standarde, përputhshmërinë ligjore dhe ofron asistencën për zhvillim në këtë drejtim. Synimi i Këshillit të Evropes[8] në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e parimeve dhe idealeve që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshem i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Bazuar në këto konsiderata, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar "Deklaratën e Strasburgut"[9], e cila ka për qëllim fuqizimin dhe promovimin e pjesëmarrjes efektive të pakicave rome në jetën shoqërore, politike dhe qytetare, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të këtyre pakicave në proceset vendimmarrës dhe përfshirjen sociale.

Një nga synimet e programit ROMACTED, i cili është vijueshmëri e programeve ROMED 2 dhe ROMACT, është hartimi i Planit të Veprimit në nivel vendor në shtatë bashki të përzgjedhura[10] nëpërmjet 4 hapave kryesore: Përgatitja e procesit; Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi; Hartimi i planit të përbashkët të veprimit; Financimi, zbatimi dhe monitorimi. Këto hapa, zbatimi i tyre dhe rezultatet e arrituara paraqiten në seksionet në vijim të këtij dokumenti.

6 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe Etika Europiane e Qeverisjes se Përsosur (ELoGE)
7 Neni 4.2.4 Romët dhe Egjiptianët
8 Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
9 Deklarata e Strasburgut mbi Romët
10 Bashkia Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Përmet, Pogradec dhe Roskovec

# III. Metodologjia dhe procesi

Metodologjia dhe procesi i përshkuar për hartimin e këtij plani veprimi është konceptuar dhe zbatuar nën një frymë të përgjithshme gjithëpërfshirëse. Kjo është mundësuar duke siguruar që çdo përpjekje e ndërmarrë në këtë kuadër të udhëhiqej nga parimet e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe integrimit. Në punën me komunitete/minoritete në nevojë në përgjithësi, dhe në rastin konkret me pakicat rome dhe egjiptiane (në vijim R&E), besohet se fuqizimi apo mundësia për fuqizim e çdo individi është thelbësore për fuqizimin dhe integrimin e të gjithë komunitetit/pakicës. Në këtë prizëm, adresimi i nevojave dhe problematikave përmes një modeli integrues, ku jetët e njerëzve dhe nevojat e tyre shihen, vlerësohen dhe asistohen nga një këndvështrim multidisiplinar dhe shumëplanësh, kanë qenë në themel të përqasjes sonë. Ndryshimet, përmirësimet dhe arritjet mund të jenë të qëndrueshme veçse përmes një strategjie të tillë, ku përqasja e integruar nënkupton nevojën për koordinim dhe sinergji në fusha si arsimi, punësimi, përkujdesi shëndetësor, strehimi dhe shërbimet shoqërore.

Për arritje të qëndrueshme, gjatë të gjitha përpjekjeve të ndërmarra u inkurajuan dhe zbatuan procese me pjesëmarrje. Pjesëmarrja e komuniteteve në të gjitha proceset i bën ato jo vetëm më të hapura, transparente dhe ndërvepruese, por shton shanset e suksesit dhe i bën proceset dhe rezultatet, që vijnë prej tyre më të pranueshme dhe të zbatueshme nga komunitetet e synuara. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të pakicave R&E në çdo hap të konceptimit të këtij plani, siguroi, ndër të tjera, që edhe të dhënat dhe evidencat e mbledhura për të ushqyer hartimin e tij të ishin të përditësuara dhe të duhura. Ato e përforcuan më tej ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjshmërisë për planin dhe zbatimin e tij.

Më konkretisht, procesi për hartimin e planit kaloi përmes katër hapave kyç, të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 1. Hapat e procesit, 2019*

### Hapi 1. Përgatitja e procesit dhe angazhimi

Detyrat e realizuara ishin:

a) Identifikimi i aktorëve – përgjatë të cilit iu dha përgjigje pyetjeve "Kush do të përfshihet?" "Pse? Ç'kontribute sjell?"

b) Garantimi i angazhimit politik – mundësoi identifikimin e aktorëve të vullnetshëm dhe çoi më tej dejt angazhimit të tyre politik për realizimin e procesit.

c) Ngritja dhe mbështjetja teknike për grupet dhe nën-grupet e punës për hartimin e planit.

### Hapi 2: Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre

Vlerësimi i nevojave të komunitetit kaloi përmes:

a) Mbledhjes së të dhënave – këtu u përcaktuan burimet e të dhënave, teknikat për mbledhjen e tyre, si dhe indikatorëve/treguesve përkatës.

b) Identifikimi dhe prioritizimi i problemeve dhe nevojave – me pjesëmarrjen e komuniteteve u identifikuan problematikat dhe nevojat e tyre si dhe u caktua se çfarë është më prioritare dhe e menjëhershme për adresim në kushtet e burimeve dhe kohës së kufizuar.

c) Vlerësimi i kapaciteteve institucionale – ku iu dha përgjigje pyetjeve "Kush mund të bëjë çfarë për adresimin e problematikave/nevojave të identifikuara?".

### Hapi 3: Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi të Përbashkët

Hapi i tretë mundësoi hartimin dhe miratimin e planit të përbashkët të veprimit dhe përfshiu reflektim dhe adresim të të mëposhtmeve:

a) Reflektim – Çfarë dimë nga procesi i vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të tyre?

b) Ku synojmë të arrijmë? Ç'ndryshime duam të sjellim?

c) Si? – aktivitete afatshkurtra & afatmesme.

d) Integrimi i çështjeve rome në planin vendor – Si? Integrimi si pjesë e së tërës. Planet Sociale.

e) Aktivitete/ndërhyrje/projekte konkrete – Çfarë? Kush? Kur?

### Hapi 4: Financimi dhe zbatimi i projektit

Hapi i katërt ndërtoi rrugën drejt një plani të zbatueshëm, duke përfshirë çështje si financimi dhe monitorimi i tij. Gjatë këtij hapi iu dha përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

a) Sa % e financimit të Planit Vendor do të mbulohet nga buxheti NJVQVsë? A parashikohen financime nga buxheti i shtetit? Donatorët?

b) A ka hendek financiar? Cilat janë burimet e mundnshme për financimin e projekteve të reja?

c) Sa % e shpenzimeve të Planit Vendor janë të planifikuara në PBAnë 2019-2021?

d) A kemi aktivitete/projekte të reja? Sa % të shpenzimeve zënë ato? Si planifikohet financimi i tyre?

e) A është hendeku financiar pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorë të ndryshëm?

Me qëllim vlerësimin e nevojave dhe informimin e proceseve vendimmarrëse lidhur me planin përmes të dhënave dhe evidencave u hartua dhe u zbatua një udhëzues për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore. Ato përfshinë burime të ndryshme, të përmbledhura në skemën ilustruese më poshtë.




*Figura 1. Burime parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura*

Për mbledhjen e të dhënave parësore përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitietit, u përdorën ushtrimet e hartëzimit të nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe. Të gjitha këto u shoqëruan me një seri vizitash dhe vëzhgimesh në terren në të gjitha zonat e Bashkisë me një përqendrim të lartë të pakicave R&E. Kështu, në periudhën shkurt-mars 2019, ekspertja kombëtare dhe lehtësuesit vendorë kanë vizituar në vazhdimësi këto zona dhe janë realizuar rreth 20 vizita në terren. Gjatë vizitave në terren, janë përdorur një seri mjetesh për mbledhjen e të dhënave. Kështu, lehtësuesti dhe ekspertja (prezente në zonat: Ish-Gjeologjikja, Bujqësorja, Konvikti i Ndërtimit etj) kanë zhvilluar intervista individuale me burra, gra dhe të rinj si dhe kanë dokumentuar vëzhgimin përmes shënimeve dhe fotografive (pasi është marrë leja).



*Figura 2. Pamje nga vizitat dhe vëzhgimet në terren (ish-konviktet)*



*Figura 3. Pamje nga vizitat dhe vëzhgimet në terren (ish-gjeologjikja)*

Gjatë vizitave të shumta në zonat e synuara janë mbajtur takime në komunitet, në mjedise të mbyllura ashtu edhe në vendqëndrimet e R&E, në mjedise të hapura. Për një diskutim më të fokusuar dhe thelluar, si dhe për njohjen më të thellë dhe tërësore të problemeve dhe nevojave janë zbatuar edhe metodat e diskutimit në

fokus-grupe, është zbatuar "Hartëzimi i Burimeve", "Pema e problemit" dhe "Matrica e Problemeve", "Prioritizimi i Problemeve" (për më shumë shiko Shtojca 9.1).



*Figura 4. Pamje nga aktivitetet për mbledhjen e të dhënave parësore (intervista, fokus-grupe, ushtrime etj.)*

Të dhëna parësore u mblodhën edhe nga Bashkia, veçanërisht në raport me kapacitetet e saj në fuksion të planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, përgjatë takimeve me grupin institucional (Shtojca 9.2).




*Figura 5. Pamje nga takimi me Grupin Institucional të Punës, Bashkia Korçë*

# IV. Profili i Bashkisë Korçë




Bashkia Korçë kufizohet në veri me Bashkinë Maliq, në lindje me Bashkinë Devoll, në perëndim me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me Bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Korçës.

Historia e qytetit modern fillon në shekullin e 15-të. Korça u rrit dhe u bë qendër kulturore, ekonomike dhe tregtie me rëndësi në shekujt 18-të dhe 19-të në Ballkan, në kuadrin e Perandorisë Osmane. Në fillim të shekullit të 19-të qyteti u përhap përreth Pazarit dhe u nda nga lumi në dy pjesë - në komunitetin Kristian dhe atë Mysliman[11]. Një ndarje e tillë u përçua edhe në një mendësi ndarjeje dhe diferencimi midis komuniteteve, gjë që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikoi edhe në nëndarje dhe dallime të tjera edhe në raport me pakicat rome dhe egjiptiane.

Shekulli i 21-të e gjen Korçën me një popullsi prej rreth 75.994 banorësh[12], ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 133.700 vetë. Bashkia e re, e dalë nga reforma territoriale 2014-2015, ka një sipërfaqe prej 805.99 $km^2$ dhe ndahet midis 8 njësive administrative: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe qarkut Korçë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 62 fshatra.

Sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik për këtë bashki përfshijnë: bujqësinë, sektorin agropërpunues, industrinë e konfeksioneve, sektorin e ndërtimit dhe atë të turizmit[13]. Disa prej tyre janë përforcuar edhe më tepër pas reformës territoriale kur bashkëngjitja me qytetin e Korçës e disa zonave rurale të cilat merren me bujqësi dhe blegtori, por edhe disa prej fshatrave turistikë më të spikatur[14], i kanë dhënë më shumë peshë dhe vëmendje këtyre sektorëve specifikë.

---

11 Bashkia Korçë (2016) Plani i Përgjithshëm Vendor (2016-2031), IDRA, Bashkia Korçë dhe Bolles dhe Wilson.
12 Sipas matjes më të fundit kombëtare nga INSTAT - CENSUS 2011.
13 Shiko për shembull dokumentin "Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Vendor, Bashkia Korçë 2005-2010".
14 Dhorjela Cule (2015) Profili i Bashkisë Korçë" Reporter.AL

Bashkia Korçë u ka dhënë formë zyrtare projekteve zhvillimore për të ardhmen si në planin ekonomik dhe në atë social. Kështu, Bashkia Korçë ka realizuar Planin e Përgjithshëm Vendor (2016-2031) si dhe planin social "Plani i Mbrojtjes Sociale, Bashkia Korçë 2019-2022". Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022, në linjë me planet e tjera zhvilluese të bashkisë, synon të sjellë arritje specifike për fuqizimin dhe integrimin e këtyre pakicave sipas nevojave të identifikuara dhe prezantuara përmbledhtazi në seksionet në vijim të këtij dokumenti.

# V. Pakicat rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë dhe vlerësimi i nevojave

Popullsia e Bashkisë Korçë është heterogjene dhe në përbërje të saj janë edhe pakica si ato vllahe, sllave, rome dhe egjiptiane. Pavarësisht Census-it të vitit 2011 dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të regjistruar dhe dokumentuar popullsinë rome dhe egjiptiane në vend, shifrat e sakta janë ende të munguara. Megjithatë, përafërsisht mund të thuhet se në Bashkinë Korçë jetojnë rreth 24,000 romë dhe egjiptianë. Popullsia rome është vendosur në Korçë relativisht vonë, rreth viteve 1920-të, në kohën e shkëmbimeve të popullsisë midis Turqisë dhe Greqisë, zhvendosur kryesisht prej Kosturit (Greqi) drejt Korçës[15]. Egjiptianët, ndërkohë, janë banues më të hershëm në gadishullin e Ballkanit. Sipas disa hulumtimeve historike egjiptianët kanë lëvizur në Mesdhe në shekullin XII para Krishtit, kur përdorimi i bronzit në ekonomi filloi të zëvendësohet nga përdorimi i hekurit – ose ndryshe quajtur epoka e hekurit.[16] Këtë e dëshmon edhe tradita e punimit të hekurit e trashëguar tek komunitetet e egjiptianëve të Shqipërisë, që ruhet edhe sot me fanatizëm.

Ndonëse, gjatë periudhës së diktaturës, romët dhe egjiptianët u përfshinë në një shkallë të lartë në sistemin arsimor të detyruar, u punësuan dhe u strehuan thuajse në të gjithë sektorët dhe zonat e qytetit, përfshirja dhe integrimi i tyre me orientim nga lart-poshtë tregoi se nuk kishte qëndrueshmëri. Me ndryshimet drastike që pësoi vendi pas viteve 90-të, shumë prej problematikave të përjashtimit social u rishfaqën me dimensionet e tyre të plota. Edhe pas thuajse tri dekadash nga ndryshimi i sistemeve, pakicat rome dhe egjiptiane në Korçë (si edhe në shumë zona të tjera) përballen me probleme të përjashtimit ekonomik, social, kulturor dhe politik.

Është pozitive dhe për t'u nënvijëzuar se pavarësisht problematikave të vazhdueshme, të tilla kanë qenë edhe përpjekjet për adresimin e tyre. Ato kanë ardhur si nga vetë komuniteti ashtu edhe nga organizata dhe donatorë që punojnë në fushë, nga institucionet e nivelit qendror dhe vendor, duke bërë që çështjet e integrimit të romëve dhe egjiptianëve të ngjiten lart në agjendat dhe prioritetet e zhvillimit vendor. Puna e mëtejshme duhet të ndërtohet mbi praktikat

15 Bashkia Korçë (2014) Plani Vendor për Zhvillimin e Komuniteteve rome dhe egjiptiane 2014-2020
16 Rubin Zemon, Historia e Egjiptianëve të Ballkanit dhe Ashkalinjve, https://www.coe.int/t/dg4/education/ibp/source/1.0_balkan_egyptian_albanian_corr.pdf

dhe përvojat e mira të deritanishme si dhe mbi pikat e forta që komuniteti gëzon. Ndër to mund të renditim: - përpjekjet e vazhdueshme dhe të pandërprera të pakicave rome dhe egjiptiane për integrim të plotë në jetën sociale të qytetit dhe për të garantuar gëzimin e të drejtave të plota dhe të barabarta me pjesën tjetër; - pavarësisht përqendrimit të pakicave në disa zona të qytetit, rezistenca për të mos u veçuar (plotësisht) nga shumica ka mbizotëruar; - janë ruajtur disa trashëgimi kulturore me përfitime ekonomike si përpunimi i thuprës, rritja e kuajve, punimi i baltës (poçeria), prodhimet artizanale me dorë, si dhe talentet muzikore dhe në pikturë; e së fundi, shpirti i sipërmarrjes (veçanërisht tek romët).

Nga ana tjetër, vëmendje duhet të marrin edhe zbutja e disavantazheve të krijuara ndër vite si dhe adresimi i pikave të dobëta që vetë komunitetet i njohin dhe pranojnë si të tilla. Ndjekja e arsimit në nivele të dobëta dhe mungesa e kualifikimeve dhe aftësimeve profesionale është një kufizim i madh në rrugën e integrimit të romëve dhe egjiptianëve. Penguese bëhen edhe një serë traditash dhe normash kulturore si martesat e hershme (shoqëruar me braktisje të shkollës), familjet e zgjeruara dhe mungesa e një kulture të përditësuar në raport me planifikimin familjar.

## V.1 Arsimi

Ka një ndërgjegjësim në rritje për rëndësinë e arsimimit dhe problematikat që shoqërojnë mungesën/nivelin e ulët të tij ndër anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane. Rritja e frekuentimit dhe cilësisë së ndjekjes së arsimit (të paktën atij të detyrueshëm) është evidentuar si një nevojë urgjente për adresim gjatë rrugës për integrimin e pakicave R&E. Marrëdhënia me arsimin dhe edukimin duhet të nisë sa më herët për të qenë e qëndrueshme dhe për të mundësuar të ndërtohet gradualisht mbi themele të forta. Aktualisht është e vështirë të përcaktohet se kur dhe sa prej fëmijëve romë dhe egjiptianë në bashkinë e Korçës janë në moshë parashkollore dhe sa prej tyre shkojnë në kopësht. Raportohet se rreth 115 fëmijë rom dhe egjiptianë janë të regjistruar në një kopësht apo parashkollor për vitin shkollor 2018-2019. Megjithatë, është e paqartë se ç'pjesë e fëmijëve romë dhe egjiptianë të po kësaj grupmoshe nuk janë pjesë. Ndër arsyet e mos-frekuentimit të sistemit parashkollor janë tarifat e vendosura, kostot e teksteve (në klasat e parashkollorit) dhe mungesa e një ndërgjegjësimi më të madh për rëndësinë e këtij cikli.

Në arsimin e detyrueshëm raportohen të jenë të regjistruar në vitin shkollor 2018-2019 rreth 1200 fëmijë romë dhe egjitianë (6-15 vjeç). Braktisja e shkollës mbetet në nivele shqetësuese me të paktën 25 nxënës ose 7% të fëmijëve R&E, që e kanë

braktisur shkollën. Edhe më shqetësuese janë arsyet e braktisjes, të cilat ndryshe nga pritshmëria se janë të lidhura kryesisht me gjendjen e rënduar ekonomike, rezultojnë të mbizotërohen më tepër nga ato kulturore, që më pas çojnë në një mbipërfaqësim të vajzave ndër fëmijët të cilët e braktisin shkollën duke iu drejtuar më pas edhe martesave të hershme.

Edhe pse cilësia e infrastrukturës së shkollave ku mësojnë shumica e fëmijëve R&E është e ngjashme me ato nënzona të tjera të bashkisë, nevojat e identifikuara janë thelbësore për tërheqjen e fëmijëve R&E drejt shkollës dhe ndërtimit të një raporti pozitiv me shkollën. Mungesa e këndeve të gjelbra, këndeve sportive dhe e aktiviteteve pas-shkollore nuk ndihmojnë në realizimin e objektivit për t'i shndërruar shkollat në qendra komunitare. Nevojitet të identifikohen dhe zbatohen praktika të mira në drejtim të rolit dhe funksionit të qendrave komunitare, punonjësve socialë, etj.

## V.2 Punësimi dhe siguria ekonomike

Pavarësisht përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm për të adresuar problematikat e punësimit midis pakicës rome dhe asaj egjiptiane, ato vazhdojnë të jenë të pranishme dhe serioze. Nga të dhëna të grumbulluara në kuadër të hartimit të këtij plani u evidentua se vetëm 7% e romëve dhe 13% e egjiptianëve në Bashkinë Korçë janë të punësuar. Pjesa dërmuese e R&E në Korçë (si edhe në vende të tjera) i sigurojnë të ardhura përmes vetëpunësimit me aktiviete të tilla si tregëtimi në pazar i produkteve artizanale (si p.sh atyre prej thupre, një traditë e trashëguar e romëve), rrobave të përdorura; pastrimi i shtëpive; kryejnë punë sezonale (p.sh në bujqësi apo në emigracion); mbledhje dhe riciklim të materialeve të ricikflueshme (plastikë, hekur etj.). Punësimet formale, ndonëse të pakta, kryesisht gjenden në sektorin privat si në fabrikën e përpunimit të duhanit (e cila për fat të keq është mbyllur së fundmi), në përpunimin e ullirit dhe në aktivitete të linjave fasoneri (si rrobaqepës/e).

Rindërtimi i "Pazarit të Vjetër" është padyshim një ndërhyrje për t'u vlerësuar si në planin e ruajtjes së vlerave dhe historisë së qytetit ashtu edhe në atë të zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë për Bashkinë Korçë. Megjithatë, ndryshimet në këtë zonë kanë mohuar aksesin, që R&E kishin në treg për aktivitetet tregëtuese. Aktualisht, zona ofron mundësi për të marrë mjedise me qera për tregëtim, por kostot janë të larta. Duke qenë se vetë R&E që kanë banuar dhe tregëtuar për dekada në këtë zonë janë, ndër të tjera, edhe pjesë e historisë që do duhej të ruhej, nxitësit dhe lehtësirat për këtë pakicë në aksesin e "Pazarit të Vjetër" do të ishin shumë të inkurajuara. Në mënyrë të ngjashme, tregu i ri "Markata e Shijes" është e vështirë

të aksesohet nga R&E pasi pagesa është relativisht e lartë. Mekanizma nxitës/ mbështetje fiskale edhe në këtë drejtim do të mundësonin rritjen e aktivitetit prodhues të pakicave R&E.

Mungesa e mundësive të punësimit nuk janë e vetmja sfidë për këto pakica. Problemet kryesore lidhen me mungesën e arsimimit dhe kualifikimit si dhe me mungesën e njohurive dhe aftësive për të kërkuar punë. Kështu, anëtarët e këtyre komuniteteve e gjejnë të vështirë të dalin përtej disa profesioneve tradicionale dhe (shpesh)  mungon vullneti për t'u kualifikuar dhe punësuar në profesione të tjera. Këto pengesa iu mbivendosen atyre që ngrihen si pasojë e diskriminimit me bazë të përkatësisë së tyre etnike si dhe ato që vijnë nga tradita dhe mendësi mbizotëruese në këto dy komunitete. Këto të fundit ndikojnë në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat. Martesat e hershme, fanatizmi i burrave të familjes, prindërimi i hershëm dhe i shumë fëmijëve janë pengesa shtesë në rrugën e vajzave dhe grave të këtyre pakicave drejt arsimimit, kualifikimeve dhe punësimit.

Zyra e punës ofron kurse profesionale për romët dhe egjiptianët, por rezultatet nuk kanë qenë shumë të ndjeshme dhe/ose të qëndrueshme. Megjithatë, arsyet e suksesit të kufizuar në këtë drejtim kërkojnë hulumtime të mëtejshme. Ndihma ekonomike dhe përfitime nga skema të tjera si ato të  aftësisë së kufizuar etj, mbeten burime të rëndësishme për shumë familje rome dhe egjiptiane. Për vitin 2019 raportohet se në Bashkinë Korçë ka 45 famije rome dhe 292 familje egjiptiane, që janë përfituese të Ndihmës Ekonomike. Gjendja e keqe e punësimit bën që familjet e këtyre pakicave të jenë të mbipërfaqësuara në skemën e Ndihmës Ekonomike, ku zënë rreth 55% të totalit prej rreth 600 familjesh përfituese.

Nga ana tjetër, shumë prej familjeve R&E janë ende të paqarta mbi kushtet e përfshirjes apo përjashtimit nga skema si dhe kanë mjaft ankesa dhe vështirësi për të siguruar pagesat e paaftësive, KEMP, kujdestaria etj. Një nga kriteret e domosdoshme për vijueshmërinë e përfitimit të Ndihmës Ekonomike është të qenit punëkërkues aktiv dhe mos-refuzimi i mundësive për punësim, që ofrohen nga Zyra e Punës. Ndonëse në parim, ky kriter është i drejtë, shpesh punët që ofrohen për pakicat R&E (veçanërisht për gratë) janë punë shumë të rënda dhe të keqpaguara, të cilat më pas refuzohen pasi nuk mund të përballohen ose nuk justifikojnë përpjekjet për punë formale kundrejt përfitimeve prej  aktiviteteve informale.

## V.3 Strehimi

Familjet rome dhe egjiptiane ndonëse kanë pësuar ndryshimet e tyre në kohë, mbeten familje të mëdha. Në Bashkinë Korçë familjet R&E përbëhen nga një mesatare prej 4-5 anëtarësh dhe në pjesën më të madhe të rasteve e ndajnë strehën e tyre me famijen e gjerë. Megjithatë, statistikat e freskuara dhe të sakta lidhur me numrin e familjeve dhe anëtarët e tyre mungojnë ose janë të vështira për t'u sigururar. Një arsye për këtë është edhe mungesa e formalizimit të lidhjeve në martesë si dhe e regjistrimit (në kohë) të fëmijëve (sidomos atyre që lindin nga nëna në moshë nën moshën ligjore për celebrim martese dhe lindje fëmije).

Në përgjithësi, gjendja e strehimit për komunitetet rom dhe egjiptiane nuk është e mirë. Problematikat e strehimit shtrihen që nga mungesa totale e tij deri tek kushtet e vështira të banesës, apo banesës së ngritur në mënyrë jo të ligjshme dhe/ose në truall që i përket dikujt tjetër (shtetit ose pronarëve privatë). Rreth 28 familje rome janë të vendosura në zonën që njihet si "Ish-gjeologjikja" dhe jo vetëm që kanë banesa të papërshtatshme (në hapësira dhe kushte banimi), por edhe janë të vendosur në një tokë me pronar privat, që vazhdimisht kërkon lirimin e saj. Problematikat më emergjente në këtë vendbanim janë rrëshkitja e dheut nga kodrina pranë këtyre banesave dhe gjendja e keqe e kanalizimeve (shpërthimi i ujërave të zeza). Uji i pijshëm është gjithashtu problem, por kanë kontata të rregullta për sigurimin e energjisë elektrike.

Një pjesë tjetër e pakicave R&E janë të strehuara në disa prej ish-konvikteve të shkollave profesionale të qytetit. Vendbanimet e njohura si "Konvikti i Bujqësores" dhe "Konvikti i Ndërtimit" kanë kushte të këqija, ku veçanërisht problematike janë sistemi i ujit të pijshëm, ai i kanalizimeve dhe grumbullimi dhe heqja e mbeturinave.

Familjet e tjera të cilat jetojnë në kasolle, përballen jo vetëm me këto problematika të sipërlistuara, por edhe me pamundësinë për të pasur lidhje elektrike dhe furnizim me ujë të pijshëm. Po kështu, këto streha nuk mund të klasifikohen edhe si përfituese të mbështetjes përmes programeve të strehimit, pasi kasollet nuk mund të rehabilitohen brenda këtyre nismave. Nga ana tjetër, familjet R&E e kanë thuajse të pamundur të përfitojnë nga programet e strehimit, që ofrojnë mundësinë e kredive të buta pasi punësimi i tyre është i parregullt dhe jo-formal në shumicën e rasteve. Në një vlerësim të përafërt, rreth 80% e familjeve R&E e kanë të pamundur të paguajnë për një kredi të butë për banesë.

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të familjeve R&E janë të lidhura me rrugë të shtruara (jo gjithmonë në gjendje të mirë), por këto mungojnë në rastin e banesave kasolle. Banesat kolektive (si ato të ish-konvikteve dhe ish-gjeologjikes)

kanë banjo të përbashkëta dhe vetëm 20% e tyre kanë ujin e pijshëm të aksesueshëm në dhomat ku banojnë. Në këto kushte jetojnë rreth 108 familje R&E (50 tek Ndërtimi, 30 tek Bujqësorja dhe 28 tek Ish-Gjeologjikja). Gjendja e tyre e vështirë ekonomike dhe sociale e bën jetesën në ato kushte edhe më të papërballueshme (si p.sh mungesa ngrohjes etj).

Nevojiten ndërhyrje të menjëhershme në banesat kolektive dhe ato në zonën e Ish-Gjeologjikes për përmirësimin e kushteve dhe/ose krijimin e mundësisë për të aksesuar shërbime. Për shembull, ndonëse aksesi në ujin e pijshëm është i mundur për sa i takon infrastrukturës, ai vështirësohet si pasojë e mos-ndarjes së konsumit dhe faturës përkatëse.

Transporti intraurban është i kushtueshëm për shumicën e famijeve R/E, megjithatë ai nuk renditet si një problem prioritar, pasi Korça është një qytet jo shumë i madh edhe distancat janë të arritshme edhe duke ecur në këmbë.

## V.4 Shëndeti

Vendbanime me përqndrim të pakicave R&E nuk janë larg qendrave shëndetësore dhe kushtet e tyre si në infrastrukturë dhe në personel janë të njëjta me pjesën tjetër të komunitetit, megjithatë aksesi që romët dhe egjiptianët kanë në shërbimet e kujdesit shëndetësor është mjaft i kufizuar. Kështu, nga popullsia totale e raportuar për këto pakica, vetëm 3,028 prej tyre (të rritur dhe fëmijë) janë të regjistruar me një mjek familjeje. Gjithashtu, raportohet se rreth 7,386 R&E kanë një kartë shëndeti (shifër që i referohet Bashkisë Korçë sipas ndarjes para reformës administrative territoriale, pasi të dhëna të përditësuara nuk mund të siguroheshin).

Marrëdhënia me tregun e punës dhe sigurimet shëndetësore është një nga pengesat kryesore në rritjen e aksesit të kujdesit shëndetësor për këto pakica. Nga ana tjetër, mungesa e informacionit dhe gjendja e vështirë ekonomike e pjesës më të madhe të familjeve R&E ndikon gjithashtu në uljen e nivelit të aksesit që anëtarët e pakicave R&E kanë në kujdes shëndetësor. Hendeku midis kërkesës (nevojave) dhe ofertës (shërbimit dhe aksesit ndaj tij) bëhet edhe më i madh duke pasur në konsideratë që kushtet e vështira të jetesës për një pjesë të komuniteteve i bëjnë nevojat e tyre për kujdes shëndetësor edhe më të mprehta.

Në këto kushte, nisma dhe masa që do të rrisnin ndërgjegjësimin si dhe nivelin e informimit mbi kujdesin dhe shërbimet shëndetësore si dhe ato që do të lehtësonin dhe rrisnin aksesin ndaj tyre janë një domosdoshmëri në këtë plan.

## V.5 Çështje të tjera

### Migrimi dhe ri-integrimi i migrantëve të kthyer

Migrimi ka prekur ndjeshëm shoqërinë shqiptare në dekadat e fundit. Pakicat rome dhe egjiptiane nuk kanë bërë përjashtim, përkundrazi. Për Bashkinë Korçë raportohet se vetëm në 3 vitet e fundit e kanë lënë vendin rreth 300 familje R&E duke u larguar drejt vendeve si Turqia, Franca, Gjermania etj. Arsyet kryesore që i kanë shtyrë familjet R&E drejt emigrimit janë ato ekonomike dhe sociale. Nga ana tjetër, duhet theksuar se një pjesë e mirë e familjeve R&E që kanë emigruar, janë rikthyer. Problematikat e migrantëve të kryer kërkojnë një vlerësim dhe adresim të dedikuar. Megjithatë, disa nga më shqetësueset pas rikthimit nga emigrimi lidhen me: - gjetjen e një pune dhe ri-integrimin në tregun e punës; - ri-integrimi i fëmijëve në sistemin arsimor dhe transferimi i dokumenteve të shkollës; regjistrimin e fëmijëve që kanë lindur jashtë vendit; etj. Për shumicën, këto procese janë shumë të vështira dhe i detyrojnë t'i drejtohen sërish ri-emigrimit/azilit. Së fundi, vihet re edhe një kalim drejt emigrimit sezonal, si dhe largimi për azil-kërkim (i cili nuk zgjat shumë), dinamika këto që janë vështirë të harmonizohen me programet e skemat e mbështetjes dhe mbrojtjes shoqërore. Këto të fundit duhet të reflektojnë një shkallë fleksibiliteti, që i përshtatet dhe adreson dinamikën e jetëve të njerëzve që pritet të mbështesin dhe mbrojnë.

### Aktivizmi qytetar dhe pjesëmarrja në vendimmarrje

Zëri i pakicave rome dhe egjiptiane ndonëse ka ardhur duke u forcuar, mbetet ende i dobët dhe i papërfaqësuar në nivele të konsiderueshme/dëshirueshme. Angazhimi qytetar në përgjithësi është i ulët, por angazhimi qytetar i komuniteteve dhe grupeve në nevojë është edhe më i rrallë dhe i vështirë. R&E në Korçë kanë disa organizata jo-qeveritare si dhe përpiqen të bëhen pjesë e proceseve vendim-marrëse në nivel bashkie. Megjithatë, organizatat janë të pakta dhe me aktivitet të ulët si pasojë e kapaciteteve dhe fondeve të kufizuara. Pakicat R&E ndonëse përbëjnë një pjesë të qenësishme të komunitetit të Bashkisë Korçë, nuk përfaqësohen në vendimmarrjen vendore. Me rritjen e anëtarëve të këtyre pakicave që janë të mirë-arsimuar dhe qytetarë aktivë, është një pritshmëri realiste që një angazhim dhe përfaqësim i pakicave R&E të ndodhë sa më parë.

# VI. Vizioni dhe objektivat e planit vendor

## VI.1 Vizioni

***Bashkia Korçë ofron mundësi të barabarta për qytetarët e saj, pavarësisht përkatësisë etnike, dhe punon për nxitjen e gjithëpërfshirjes, multikulturalizmit dhe integrimin me të drejta të plota e të barabarta të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, drejt një integrimi të plotë ekomonik, social, kulturor dhe politik, në respekt të tipareve të veçanta dhe ruajtjes së identitetit kulturor.***

## VI.2 Objektivat strategjikë

- Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë.
- Fuqizimi ekonomik i pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes integrimit dhe harmonizimit të ndërhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale.
- Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme.
- Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në Bashkinë Korçë
- Ri-integrimi i familjeve rome dhe egjiptiane të kthyera nga migrimi.
- Fuqizimi i aktivizmit dhe përfaqësimit politik dhe atij në vendimmarrje të romëve dhe egjiptianëve në Bashkinë Korçë

# VII. Plani i masave

| Masa/aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi (lekë) | Monitorimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Fusha e ndërhyrjes – ARSIMI** | | | | | | |
| **Objektivi strategjik: Përmirësimi i situatës arsimore të pakicave R&E në Bashkinë Korçë** | | | | | | |
| **1.1 Objektivi specifik: Lehtësimi i aksesit ndaj shërbimeve arsimore** | | | | | | |
| 1.1.1 Mbështetja financiare e fëmijëve nga pakicat R&E që jetojnë në familje me vështirësi ekonomike (në të gjitha nivelet e shkollimit, përmes a. Vazhdimit të përjashtimeve nga tarifat – kopësht; b.Bursave (shkolla profesionale dhe gjimnaze);<br>c. Sigurimit të librave/mjeteve shkollore (edhe për nivelin parashkollor). | Bashkia Korçë | Numri i fëmijëve të mbështetur<br><br>Numri i fëmijëve të integruar në mënyrë të qëndrueshme | Bashkia Korçë<br><br>DAR<br><br>Drejtoritë e shkollave specifike | Çdo vit akademik për periudhën e këtij plani 2019-2022 | 31,600,000.00<br>Bashkia Korçë<br><br>Misioni Emanuel, World Vision, TDH, Fondacioni Kenedi, MEDPAK | Bashkia Korçë<br><br>DAR<br><br>OSHC-të |
| 1.1.2 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore (mjedise sportive, të gjelbra etj) duke filluar me:<br>a.Shkolla "Asdreni"<br>b. Shkolla "Nuçi Naçi" | Bashkia Korçë | Projekti i planifikuar<br><br>Të dhëna dokumentuese të projektit të zbatuar<br><br>Numri i fëmijëve dhe stafit përfitues | Bashkia Korçë<br><br>DAR<br><br>Drejtoritë e shkollave përfituese | 2019-2020 | 81,559,495.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br><br>DAR<br><br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.3 Vendosja e mësuesve ndihmës për fëmijët me vështirësi/ nevoja të veçanta nga pakicat R&E (përfshi ata të kthyer nga migrimi) – duke filluar nga Qendra Komunitare 3. | DAR | Numri i shkollave përfituese<br><br>Numri i mësuesve të angazhuar<br><br>Numri i fëmijëve përfitues<br><br>Kohëzgjatja e shërbimit të vendosur | DAR<br><br>Drejtoritë e shkollave përfituese | Çdo vit akademik për periudhën e këtij plani 2019-2022 | 30,312,000.00<br>MASR/ DAR<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br><br>DAR<br><br>OSHC-të<br><br>KMD |
| 1.1.4 Ndërgjëgjësimi dhe krijimi i lehtësive për frekuentimin e çerdheve nga fëmijë të pakicave R&E (përfshirë edhe në çerdhen e re  në L.2). | Bashkia Korçë | Numri i fushatave ndërgjegjesuese<br>Numri i familjeve të synuara<br>Numri i fëmijëve përfitues | Bashkia Korçë<br>Partnerë ose Bashkia | 2020 | 14,876,400.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>Qendrat Shëndetësore<br>OSHC-të |

| Fusha e ndërhyrjes – PUNËSIMI DHE FUQIZIMI EKONOMIK | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik: Fuqizimi ekonomik i pakicave R&E në Bashkinë Korçë, përmes integrimit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale** | | | | | | |
| **Masa/aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Fondet/ Financimi (lekë)** | **Monitorimi** |
| **2.1 Objektivi Specifik: Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i aksesit ndaj shërbimeve të punësimit dhe tregut të punës** | | | | | | |
| 2.1.1 Fushata dhe aktivitete ndërgjegjësuese për mundësitë dhe shërbimet e punësimit | Zyra e Punësimit Korçë (ZPK)<br><br>OSHC-të<br><br>Bashkia Korçë | Numri i fushatave të ndërmarra<br><br>Numri i aktiviteteve të mbajtuara<br><br>Numri i pjesëmarrësve<br><br>Numri i aplikimeve të reja<br><br>Numri i aplikimeve të suksesshme | ZPK<br><br>OSHC-të e përfshira<br><br>Bashkia Korçë | Çdo vit 2019-2022 | 12,000,000.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.1.2 Aktivitete ndërgjegjësuese me punëdhënës/biznese aktive në Bashkinë Korçë, mbi punësimin e R&E | Zyra e Punësimit Korçë (ZPK)<br><br>OSHC-të<br><br>Bashkia Korçë | Numri i aktiviteteve të mbajtuara<br><br>Numri i pjesëmarrësve | ZPK<br><br>OSHC-të e përfshira<br><br>Bashkia Korçë | Çdo vit 2019-2022 | 1,600,000.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.3 Mbështetje e personalizuar për aplikime për punëkërkim tek anëtarët e pakicaveR&E që zotërojnë shkollim/ kualifikim profesional | ZPK<br>OSHC-të<br>Bashkia Korçë | Numri i stafit të angazuar në dhënien e asistencës<br>Numri i rasteve të mbështetura<br>Numri i aplikimeve për punëkërkim<br>Numri i rasteve të suksesshme<br>Numri i punësimeve të qëndrueshme (me kontrata, më shumë se 6 muaj) | ZPK<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të e përfshira | Çdo vit 2019-2022 | 1,400,000.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.1.4 Trajnim dhe mbështetje në procesin e punëkërkimit përmes përdorimit të faqes http://www.puna.gov.al/Default.aspx | ZPK<br>OSHC-të<br>Qendra Komunitare Korçë | Numri i trajnimeve<br>Numri i përfituesve<br>Niveli i ndryshuar i shprehive/aftësive<br>Numri i rasteve të suksesshme përmes përdorimit të portalit | ZPK<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të e përfshira | Çdo vit 2019-2022 | 1,800,000.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të | Qendra Komunitare Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.1.5 Informim dhe mbështetje për aplikim në skemat e granteve në mbështetje të aktivitetit bujqësor/ blegëtoral | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i aplikimeve<br>Numri i granteve të fituara<br>Numri i përfituesve direkt dhe indirekt | Bashkia Korçë | Çdo vit 2019-2022 | 3,000,000.00<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

| **2.2 Objektivi Specifik: Rritja e punësimit të pakicave R&E përmes mekanizmave nxitës për punëdhënësit dhe formalizimit të aktiviteteve prodhuese** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.1 Vendosja e mekanizmave nxitës për bizneset që vendosin kuota/punësojnë anëtarë të pakicave R&E<br>(p.sh lehtësime në taksat vendore etj.) | Bashkia Korçë<br><br>ZPK<br>Ministria e Linjës | Numri i nismave të ndërmara dhe llojeve të mekanizmave nxitës të ofruar<br>Numri dhe përmbajtja e vendimeve përkatëse<br>Numri i bizneseve pjesëmarrëse<br>Numri i R&E që kanë përfituar | ZPK<br>Bashkia Korçë | Duke filluar nga 2021<br>Në vazhdim | 369,600.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.2.2 Mbështetja/ lehtësimi i procedurave të regjistrimit të aktiviteteve prodhuese të anëtareve të pakicave R&E (me qëllim mundësimin e sigurimeve shoqërore/ shëndetësore, aksesin në kredi etj).<br><br>Mbajtja e takimeve informuese/ ndërgjegjësuese me Zyrën e Taksave Vendore. | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>QKB Korçë | Numri i aktiviteteve të mbajtuara<br>Numri i pjesëmarësve në to<br>Numri i aktiviteteve ekonomike të identifikuara<br>Numri i aktiviteteve ekonomike të formalizuara (regjistruara)<br>Numri i të punësuarve në to | Bashkia Korçë<br>QKB Korçë | Duke filluar nga 2020 | 240,000.00<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.3 Mbështetja me fonde për biznese të rinj<br>Start up activities (dhënia prioritet e bizneseve që ruajnë traditat e pakicave R&E si qëndistari, tezgjah, përpunim thupre, kovaçanë, poçeri etj) | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i bizneseve të mbështetura<br>Numri i përfituesve<br>Të ardhurat e gjeneru-ara nga këto biznese | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Çdo vit 2019-2022 | 8,000,000.00<br>Terre des Homes<br>World Vision | Bashkia Korçë<br>ZPK |
| 2.2.4 Mbështetja e ngritjes së një "inkubatori biznesi" në zonën e "Paza-rit të vjetër" (duke përfshirë: mbulim qeraje; përjash-timi nga tatimi për 6 mtiuaj; aplikim i tarifafe fiskale per artizanatin; etj). | Bashkia Korçë | Numri i përfituesve<br>Të ardhurat e gjeneru-ara nga këto bznese | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020<br>2021 | 24,400,000.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 2.2.5 Monitorimi i res-pektimit të rregullave dhe kushteve të punës për punëmar-rësit R&E | Inspektoriati i Punës<br>ZPK<br>Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi<br>OSHC-të | Numri i monitorimeve të kryera<br>Numri i parregullsive të identifikuara<br>Numri i masave ndësh-kimore | ZPK<br>Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi<br>OSHC-të | 2019-2022 | 1,000,000.00<br>ZPK<br>Inspektoriati i Punës<br>KMD | Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |

| 2.3 Objektivi specifik: Integrimi i pakicave R&E në programet e kualifikimit dhe rritja e kapaciteteve të tyre profesionale | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3.1 Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe kualifikim profesional | Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të<br>ZPK | Numri i nismave të ndërmarra<br>Raporti i vlerësimit/ gjetjet e vlerësimit | OSHC-të<br>ZPK | 2019 e në vazhdim | 1,200,000.00<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.3.2 Identifikimi i rasteve në nevojë dhe të gatshëm për trajnim/kualifikim profesional | ZPK<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të<br>Bashkia Korçë | Numri i rasteve të identifikuara<br>Numri i të regjistruarve në kurse trajuese/kualifikuese<br>Numri i atyre që kanë përfunduar me sukses<br>Numri i atyre që janë punësuar/kanë filluar një aktivitet ekonomik. | ZPK<br>OSHC-të | 2019 e në vazhdim | 5,600,000.00<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.3.3 Koordinimi/ ndërmjetësimi midis ofruesve të kurseve trajnuese/kualifikuese dhe punëdhënësve<br>Krijimi i një regjistri të përbashkët midis ofruesve dhe punëkërkuesve. | ZPK<br>OSHC-të<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë | Partneritetet e vendosura<br>Numri i të punësuarve përmes tyre | ZPK<br>OSHC-të | 2019 e në vazhdim | 1,500,000.00<br>Bashkia Korçë<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |
| 2.3.4 Ndërmjetësimi/ lehtësimi i njohjes së kurrikulave për kurse formimi në specialitetet e pakicave R&E (si qëndistari, përpunim thupre, kovaçanë, poçeri etj.) | Qendra për Formim Profesional (QFP)<br>Qendra Komunitare Korçë | Numri i kurrikulave të hartuara dhe miratuara<br>Numri i përfituesve prej aplikimit të tyre | QFP<br>OSHC-të | 2020 | 239,200.00<br>QFP<br>ZPK | Qendra Komunitare Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të |

| Fusha e ndërhyrjes – STREHIMI | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik: Përmirësimi i gjendjes së strehimit të pakicave R&E në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme.** | | | | | | |
| **Masa/aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Fondet/ Financimi (lekë)** | **Moni-torimi** |
| **3.1 Objektivi specifik: Përmirësim i kushteve në banesat ekzistuese të minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë** | | | | | | |
| 3.1.1 Vlerësimi i nevojave dhe identifikimi i banesave që kanë nevojë për ndërhyrje | Bashkia Korçë OSHC-të | Numri i banesave të identifikuara<br>Treguesit mbi gjendjen e tyre | Bashkia Korçë OSHC-të | Çdo vit 2019-2022 | 797,440.00 Bashkia Korçë | Bashkia Korçë OSHC-të |
| 3.1.2 Ndërgjegjësim për rëndësinë e lidhjes dhe pagesave të rregullta të kontratave të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike (veçanërisht në banesat kolektive të R&E). | MEI/ OSHEE<br>Qendra Komunitare Korçë | Numri i familjeve përfituese<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë OSHC-të | 2020 | 1,232,000.00 MEI/ OSHEE | Qendra Komunitar-eKorçë OSHC-të |
| 3.1.3 Rehabilitimi dhe sistemimi i kanalizimeve në zonat me popullsi R&E (prioritare Ish-gjeologjikja, Ndërtimi, Bujqësorja) | Bashkia Korçë | Numri i projekteve të zbatuara<br>Numri i familjeve përfituese<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë OSHC-të | 2020 | 1,900,000.00 Bashkia Korçë | Bashkia Korçë OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.4 Kërkesë ndaj të kontaktuarve për pastrimin e qytetit për një vëmendje të shtuar në zonën e ish-konviktit të Ndërtimit si dhe angazhimi i 1-2 administratorëve nga ky komunitet për mundësimin e rezultateve të qëndrueshme në mirëmbajtjen e godinës dhe mjedisit përrreth. | Bashkia Korçë | Numri i familjeve përfituese<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2019 | 887,040.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| **3.2 Objektivi specifik: Rritja e mundësive për strehim përmes formalizimit të banesave ekzistuese dhe ndërtimit të banesave sociale** | | | | | | |
| 3.2.1 Identifikimi i rasteve për formalizim (regjistrim) të banesave të ndërtuara në mënyrë jo-ligjore/të parregullt | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i rasteve të identifikuara | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2019 | 308,000.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 3.2.2 Lehtësimi i kritereve të vendosura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për regjistrimin e banesave të paqëndrueshme | ASHK<br>Bashkia Korçë | Numri i aplikimeve<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 | 152,000.00<br>ASHK<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 3.2.3 Sigurimi i asistencës juridike për anëtarët e minoriteteve R&E që kanë probleme dokumentacioni/regjistrimi/ procesi gjyqësor | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i të asistuarve<br>Numri i rasteve të mbylluara me sukses | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Vazhdimisht 2019-2022 | 3,000,000.00<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 3.2.4 Vijimi i përcaktimit të kuotave (%) për R&E në përfitimin nga banesat sociale (përfshi lehtësimin e procedurave/ kushteve). | MFE<br>Bashkia Korçë | Numri i projekteve<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2021 | 739,200.00<br>MFE<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 3.2.5 Mbështetja e familjeve të pastreha me pagesa qeraje (duke filluar me familjet e ish-gjeologjikes) dhe vendosja e tyre në lista prioritare për skemat e punësimit | Bashkia Korçë | Numri i familjeve të mbështetura<br>Numri i përfituesve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 | 6,000,000.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

| **IV. Fusha e ndërhyrjes: SHËNDETI** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik: Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e pakicave R&E në Bashkinë Korçë** | | | | | | |
| **Masa/aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhë-nave** | **Afatet** | **Fondet/ Financimi (lekë)** | **Monitorimi** |
| **4.1 Objetivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe aksesit ndaj shërbimeve shëndetësore për anaëtarët e paki-cave R&E** | | | | | | |
| 4.1.1 Lehtësimi i regjistrimit dhe aksesit të fëmijëve të paregjis-truar në shërbimet e kujdesit shëndetësor; Ndërgjegjësimi për rëndësinë si dhe nxitja me bonusin e lindjes. | Qendra Komu-nitare Korçë<br>NjMF-ja<br>OSHC-të | Numri i rasteve të identifikuara<br>Numri i nismave të ndërmara<br>Numri i për-fituesve | Bashkia Korçë<br>DAR<br>Drejtoria e Shëndetit Publik (DSHP) | 2019 e në vazh-dim | 444,800.00<br>Bashkia Korçë | Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 4.1.2 Monitorimi i situatës së vaksinimit në zonat përqendrim R&E dhe mundësimi/nxitja e vak-sinimit për rastet e identifikuara me mangësi | DSHP<br>Qendra Komu-nitare Korçë<br><br>Bashkia Korçë, NjMF-ja | Numri i rasteve të identifikuara<br>Numri i rasteve të adresuara | DSHP<br>Bashkia Korçë, NjMF-ja | 2019 e në vazh-dim | 800,000.00<br>DSHP | Qendra Komunitare Korçë<br><br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.3 Fushata ndërgjegjësuese për rëndësinë e kujdesit shëndetësor, shëndetin e nënës dhe fëmijës, ndryshimin e kushteve dhe procedurave për KEMP | DSHP<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të | Numri i nismave të ndërmarra<br>Numri i personave të synuar | DSHP<br>Bashkia Korçë | 2019 e në vazhdim | 6,000,000.00<br>DSHP | Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| **4.2 Objektiv specifik: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit shëndetësor që marrin anëtarët e minoriteteve R&E** | | | | | | |
| 4.2.1 Vlerësimi i nevojave infrastrukturore dhe për mjete sipas qendrave shëndetësore | MSHMS<br>Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë | Numri i subjekteve të vlerësuara<br>Gjendja e raportuar | MSHMS<br>Bashkia Korçë | 2020 | 184,800.00<br>MSHMS<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 4.2.2 Garantimi i kontrolleve për kushtet higjenosanitare në vendqëndrimet rome (nga Drejtoria Rajonale e Kujdesit Shendetësor dhe Mbrojtjes Sociale) | Drejtoria e Shëndeti Publik (DSHP)<br>OSHC-të | Numri i inspektimeve<br>Raportet e gjendjes | DSHP<br><br>OSHC-të | 2019 e në vazhdim | 10,400,000.00<br>DSHP | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 4.2.3 Ngritja dhe venia në funksionim e qendrës "Kujdesi i Nënës dhe Fëmijës" | Bashkia Korçë | Numri i projekteve/ nismave<br>Numri i shërbimeve të ofruara<br>Numri i përfituesve | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2021 | 23,000,000.00<br>MSHMS | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

| **Fusha e ndërhyrjes: Të tjera –MIGRIMI; AKTIVIZMI DHE PJESËMARRJA NË VENDIMMARJE** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi strategjik: Ri-integrimi i familjeve R&E të kthyera nga migrimi.** | | | | | | |
| **Masa/aktiviteti** | **Aktorët** | **Treguesit e rezultateve** | **Burimet e të dhënave** | **Afatet** | **Fondet/ Financimi (lekë)** | **Monitorimi** |
| **5.1 Objektivi specifik: Lehtësimi i proceseve ri-integruese për famijet R&E të kthyera nga migrimi.** | | | | | | |
| 5.1.1 Identifikimi i familjeve R&E të kthyera nga migrimi | Bashkia Korçë,<br>NjMF-ja<br>ZPK | Numri i familjeve të identifikuara | Bashkia Korçë<br>ZPK | 2019 e në vazhdim | 1,067,520.00<br>Bashkia Korçë,<br>NjMF-ja<br>ZPK | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 5.1.2 Vlerësimi i nevojave të familjeve R&E të kthyera nga migrimi | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i vlerësimeve të kryera<br>Raportet | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2019 e në vazhdim | 2,135,040.00<br>Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 5.1.3 Identifikimi i fëmijëve R&E të kthyer që kanë nevojë të mbështeten në procesin e ri-integrimit në shkollë/vit shkollor të caktuar | Bashkia Korçë,<br>NjMF-ja<br>DAR<br>OSHC-të | Numri i fëmijëve të identifikuar<br>Numri i fëmijëve të mbështetur<br>Numri i fëmijëve të ri-integruar | Bashkia Korçë<br>DAR | 2019 e në vazhdim | 800,640.00<br>Qendra Komunitare KorçëWorld Vision<br>Misioni Emanuel<br>Terre des Hommes | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.4 Mundësimi i pajisjes me karta shëndeti dhe kartelën e vaksinimit për fëmijët që një pjesë të jetës së tyre kanë jetuar diku tjetër (shiko fushën e shëndetit). | Bashkia Korçë,<br>NjMF-ja<br>DSHP | Numri i fëmijëve të identifikuar<br>Numri i fëmijëve përfitues | Bashkia Korçë<br>DSHP | 2019 e në vazh-dim | 560,448.00<br>DSHP<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 5.1.5 Ndërgjegjësimi për problematikat që shoqërojnë emigrimin e parregullt. | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i nismave të ndërmarra<br>Numri i të synu-arve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2019 e në vazh-dim | 2,000,000.00<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| **Objektiv Stategjik: Fuqizimi i aktivizmit dhe përfaqësimit të pakicave R&E, në Bashkinë Korçë** | | | | | | |
| **5.2 Objektivi specifik: Fuqizimi i aktivizmit qytetar dhe organizatave R&E** | | | | | | |
| 5.2.1 Mbështetja e kulturës dhe aktivizmit rom dhe egjip-tian me fonde dhe aktivitete (të paktën 2 evente në vit si psh 8 Prilli , 6 Maji apo 24 qershori) | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i aktiv-iteteve<br>Buxheti i alokuar | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 e në vijim | 4,200,000.00<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të<br>Biznesi lokal | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.2.2 Forcimi i lidhjes midis OSHC-ve R&E, Bashkisë dhe aktorëve të tjerë vendore përmes aktiviteteve të përbashkëta | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i aktiviteteve<br>Buxheti i alokuar | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 e në vijim | 800,640.00<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| 5.2.3 Mbështetja e aktiviteteve sportive dhe kulturore që promovojnë vlerat e multikulturalizmit. | Bashkia Korçë | Numri i aktiviteteve<br>Buxheti i alokuar | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 e në vijim | 1,500,000.00<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të<br>Biznesi lokal | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të |
| **5.3 Objektivi specifik: Rritja e përfaqësimit politik dhe pjesëmarrjes në vendimmarje të R&E** | | | | | | |
| 5.3.1 Rezervimi i vendeve/kuotave të punësimit për minoritetet në Bashki, përfshirë rekrutimet në Qendren Komunitare Korçë (duke parashikuar %R&E) | Bashkia Korçë<br>ZPK | Numri i R&E të punësuar në bashki dhe strukturat e saj | Bashkia Korçë<br>ZPK<br>OSHC-të | 2020 | 117,872.00<br>Bashkia Korçë | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 5.3.2 Ofrimi i intershipeve për pakicat R&E | Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë | Numri i përfituesve<br>Kushtet e intershipit<br>Numri i të punësuarve pas intershipit | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2020 e në vijim | 1,844,064.00<br>Bashkia Korçë<br>Qendra Komunitare Korçë<br>OSHC-të<br>Biznesi lokal | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.3.3 Rezervimi i vendeve në listën e kandidatëve për Këshill Bashkiak | Partitë Politike<br>OSHC-të | Vendet e rezer-vuara<br>Kanditatët e përf-shirë<br>Kandidatët fitues | OSHC-të | 2019 | 90,072.00<br>- | Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 5.3.4 Fushata ndërgjegjësimi për aktivizmin dhe pjesëmar-rjen politike/vendimmarrëse në komunitetet R&E | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Numri i nismave të ndërmarra<br>Numri i të targetu-arve | Bashkia Korçë<br>OSHC-të | 2019 e në vijim | 1,200,000.00<br>Qendra Komuni-tare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të |
| 5.3.5 Punësimi i koordinatorit të Qendrës Komunitare | Bashkia Korçë | Punësimi i per-sonelit<br>Përshkrimi i pu-nës/kontrata | Bashkia Korçë | 2019 | 1,946,688.00<br>Qendra Komuni-tare Korçë<br>Bashkia Korçë | Qendra Komunitare Korçë<br>Bashkia Korçë<br>OSHC-të |

# VIII. Burimet financiare

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, të nevojshme për zbatimin e "Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022" për Bashkinë Korçë.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në informacionet e ofruara nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe të gjitha Drejtoritë e përfshira në zbatimin e këtij plani veprimi. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë dhe për një pjesë të aktiviteteve janë përgjegjëse institucione të tjera. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete. Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale u mbajt në konsideratë kohështrirja e masës, numri i aktiviteteve që do të realizohen, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj.

Në disa raste u përdor dhe vlerësimi për analogji, sidomos në projektet e infrastrukturës, strehimit social dhe shëndetësisë, i cili merr në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme. Për aktivitetet që planifikohen të mbulohen nga buxheti i qeverisë qëndore u mbajtën në konsideratë kostot për njësi sipas PBA 2019-2021. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua gjithashtu bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor dhe metodologjinë e hartimit të buxhetit afatmesëm.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave, nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 294.8 milionë lekë ose afërsisht 2.36 milionë euro[17]. Alokimi i fondeve për periudhën 2019-2022 u programua duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020-2022). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 53.6% të kostos së planit të veprimit, përkatësisht rreth 158.1 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga bashkia mbulojnë 15.0% të kostos së planit të veprimit ose 44.3 milionë lekë.

Tabela 1 paraqet buxhetin në vite sipas fushave. 51.7% e shpenzimeve nevojiten për fushën e "Arsimit dhe promovimit të dialogut ndërkulturorë", ndërsa 21.1% e shpenzimeve nevojiten për "Punësimin dhe fuqizimin ekonomik".

17 Kursi këmbimit 1Euro=125 lekë

**Tabela 1: Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2019-2022**

| PËRSHKRIMI | Buxheti 2019-2022 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVAT** | **VITI 2019** | **VITI 2020** | **VITI 2021** | **VITI 2022** | **TOTALI** |
| Përmirësimi i situatës arsimore të minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë | 57,050,839.00 | 63,341,056.00 | 22,478,000.00 | 15,478,000.00 | 158,347,895.00 |
| Fuqizimi ekonomik i minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë, përmes integrimit dhe harmonizimit të ndërhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale | 8,610,000.00 | 34,922,400.00 | 9,333,200.00 | 9,483,200.00 | 62,348,800.00 |
| Përmirësimi i gjendjes së strehimit të minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme | 1,821,920.00 | 5,685,920.00 | 3,753,920.00 | 3,753,920.00 | 15,015,680.00 |
| Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë | 4,411,200.00 | 4,472,800.00 | 25,972,800.00 | 5,972,800.00 | 40,829,600.00 |
| Ri-integrimi i familjeve R&E të kthyera nga migrimi | 2,517,656.00 | 5,327,024.00 | 5,209,152.00 | 5,209,152.00 | 18,262,984.00 |
| **Total (1+ 2 +3 +4 +5 )** | **74,411,615.00** | **113,749,200.00** | **66,747,072.00** | **39,897,072.00** | **294,804,959.00** |

Tabela 2 paraqet shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifikë. Shpenzimet për disa aktivitete në fushën e arsimit dhe fuqizimit ekonomik janë konsideruar pjesërisht si hendek financiar. Hendeku lidhet kryesisht masat për vendosjen e mësuesëve ndihmës, për miratimin e incentivave për çerdhet e fëmiëve. Ndërsa hendeku financiar për fushën e fuqizimit ekonomik dhe punësimit lidhet kryesisht me projektin " Mbështetja e ngritjes së një "inkubatori biznesi" në zonën e "Pazarit të vjetër" " Hendeku financiar i pambuluar nga të gjitha burimet e financimit është 28.4%. Një pjesë e hendekut financiar kërkon alokimin e fondeve nga bashkia dhe buxheti i shtetit, ndërsa pjesa tjetër mendohet të mbulohet nga donatorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile.

**Tabela 2: Shpenzimet sipas burimeve të financimit**

| PËRSHKRIMI | FINANCUAR NGA | | | | | Nevojat për |
|---|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Bashkia | Qeveria | Donatorët | Të tjerë | Totali | Fonde LEKË |
| Përmirësimi i situatës arsimore të minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë | 21,281,290.00 | 91,878,205.00 | 0.00 | 0.00 | 113,159,495.00 | 45,188,400.00 |
| Fuqizimi ekonomik i minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë, përmes integrimit dhe harmonizimit të ndërhyjeve për kualifikime, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale | 5,209,600.00 | 21,179,200.00 | 0.00 | 0.00 | 26,388,800.00 | 35,960,000.00 |
| Përmirësimi i gjendjes së strehimit të minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme | 7,190,640.00 | 3,152,000.00 | 0.00 | 4,673,040.00 | 15,015,680.00 | 0.00 |
| Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e minoriteteve R&E në Bashkinë Korçë | 222,400.00 | 40,384,800.00 | 0.00 | 222,400.00 | 40,829,600.00 | 0.00 |
| Ri-integrimi i familjeve R&E të kthyera nga migrimi | 10,424,192.00 | 1,494,528.00 | 2,486,672.00 | 1,157,592.00 | 15,562,984.00 | 2,700,000.00 |
| **Total (1+2+3+4+5)** | **44,328,122.00** | **158,088,733.00** | **2,486,672.00** | **6,053,032.00** | **210,956,559.00** | **83,848,400.00** |

# VIII. Monitorimi dhe vlerësimi

Plani për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor është një dokument politik e zhvillimi i Bashkisë Korçë për komunitetet e synuara dhe nuk duhet të përfundojë me miratimin e tij nga Kryetari dhe Këshilli Bashkiak. Monitorimi i rregullt i planit vendor për integrimin e R&E në intervale të caktuara kohore, grumbullimi i të dhënave të treguesve të matshëm dhe vlerësimi i impaktit në përmirësimin e aksesit në shërbimet publike të ofruara për minoritetet dhe publikimi i rezultateve të zbatimit të masave është një përgjegjesi institucionale e bashkisë dhe që bazohet në parimet e besueshmërisë së qeverisjes vendore, jodiskriminimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe informimit publik.

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të ushqejnë orientimin e politikave të reja dhe shpërndarjen e burimeve në nivel vendor në kuadër të planifikimit strategjik dhe procesit të vendim-marrjes vendore. Gjithashtu, raportet e monitorimit do të ofrojnë informacion të vlefshëm dhe cilësor në kuadër të raportimit të sistemit ROMALB që kryhet dy herë në vit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në nivel të lartë, raporti i monitorimit do të lehtësojë vendim-marrjen e informuar të grupit të lartë të menaxhimit të politikave në nivel vendor, i cili do të jetë/ është përgjegjes për monitorimin e progresit të të gjitha planeve të zhvillimit të miratuara nga Bashkia, si Planin e Përgjithshëm Vendor, procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe të buxhetit. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave/aktiviteteve të Planit për integrimin e R&E të Bashkisë do të paraqitet në mënyrë periodike (të paktën 1 herë/ose dy herë në vit).

Në nivel operacional, për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Integrimin e R&E në Bashkinë Korçë, struktura përgjegjëse do të jetë Drejtoria e Shërbimit Social dhe koordinatorja e pakicave si pjesë e drejtorisë. Drejtoria e Shërbimit Social është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore nga të gjitha strukturat e Bashkisë sipas sektorëve përkatës si dhe nga të gjitha institucionet e tjera publike. Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit të planit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progres-raporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile (përfshirë raporte hije të organizatave R&E në nivel vendor).

Sfida për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet rritja e kapaciteteve të vetë stafit të bashkisë, përmirësimi i shkallës së përgjegjshmërisë të strukturave të tjera të bashkisë si dhe bashkëpunimi dhe ndërveprimi me

strukturat e tjera të nivelit vendor në varësi të institucioneve qendrore.

*Procesi i vetë-deklarimit si Romë ose Egjiptianë nuk është i standardizuar dhe disa struktura në nivel vendor ngurojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë dhe të drejtën e vetë-deklarimit, që sanksionohet me ligj. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha zyrat publike përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë së Romëve dhe Egjiptianëve. Mungojnë veçanërisht të dhënat mbi gjendjen e Egjiptianëve*[18].

Në nivel të sektorëve prioritarë dhe të objektivave strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate nëpërmjet treguesve të matshëm, si dhe vëzhgimit mbi cilësinë dhe aksesueshmërinë në shërbimet publike të Romëve dhe Egjiptianëve. Këto vëzhgime vjetore duhet të ndërmerren nga bashkia në bashkëpunim me organizata komunitare dhe OSHC, ose si raportime të veçanta në varësi të nevojave dhe dakordësisë. Rezultatet e vëzhgimeve duhet të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë dhe sistemin ROMALB.

Monitorimi i planit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, ndonëse një përgjegjësi e drejtpërdrejtë e bashkisë për kompletimin e ciklit të kësaj politike vendore, mund të mbështetet edhe me ekspertizë të jashtme nga projekte të agjencive donatore, të paktën për vitin e parë, të cilat në procesin e realizimit të monitorimit do të ndihmojnë në zhvillimin *e njohurive* dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës vendore në drejtim të monitorimit dhe raportimit.

Bashkia përditëson rregullisht sistemin elektronik online "ROMALB" për regjistrimin dhe rifreskimin e të dhënave për treguesit e Planit të Veprimit NAPIRE, 2016-2020, dhe MSHMS ofron mbështetje teknike dhe trajnime për përdoruesit e sistemit në Bashki.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit për integrimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane në nivel vendor, do të jetë seti i indikatorëve/treguesve sipas fushave dhe aktiviteteve dhe afatet kohore:

Krijimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së Grupit të Institucional të Punës që do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin në nivel të lartë të zbatimit të planit të veprimit.

Ngarkimi i nëpunësve vendorë përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin në nivel operacional te masave të Planit Vendor për integrimin e planit të veprimit (psh. Nëpunës nga Drejtoria e Shërbimit Social).

18 The National Action Plan for the Integration of Roma and Egyptians (NAPIRE) 2016-2020

Forcimi i bashkëpunimit me organizatat komunitare dhe OSHC (organizata vendore) me grup të synuar komunitetet Rome dhe Egjiptiane, si dhe me lehtësuesit / ose pikat e kontaktit të romëve.

Sigurimi i bashkëpunimit me projekte te financuara nga agjenci donatore për mbështetje dhe ekspertizë të jashtme.

# IX. Shtojca

## IX.1 Metoda dhe teknika për mbledhjen e të dhënave parësore, me pjesëmarrjen e komunitetit

### Hartëzimi i Burimeve

Gjatë hartëzimit të burimeve hartat përdoren për të pasur një pasqyrë të burimeve dhe shpërndarjes së tyre. Në mënyrë të veçantë ato na shërbejnë kur duam të dimë se ku janë të vendosura burimet që përdor komuniteti që është në fokus të mbledhjes së të dhënave. Me interes mund të jetë të hartëzohen burime të tilla si burimet e ujit (të pijshëm apo për ujitje), vendndodhja e tokave të punueshme dhe atyre që kanë ujitje, vendndodhja e tregut të fruta-perimeve apo atij të rrobave të përdorura, që shërbejnë si burime punësimi dhe të ardhurash për komunitetin, e kështu me radhë.

Në mënyrë të ngjashme, lehtësuesi vendos në dispozicion një hartë të zonës/ komunitetit të synuar dhe u kërkon përfaqësuesve të komunitetit të identifikojnë burimet dhe vendosin ato në hartë sipas shpërndarjes. Ky proces jep mundësi për të diskutuar bollëkun apo mungesën e burimeve, nivelin e aksesit dhe kontrollit ndaj tyre si dhe pengesat dhe mundësitë drejt përdorimit dhe/ose shtimit të tyre.

### Diskutimet në Fokus-Grup

Organizimi i fokusgrupeve rekomandohet nëse vlerësoni se ka nevojë për informacione shtesë nga anëtarët e komunitetit (kryesisht grupe homogjene, por të nënpërfaqësuara si p.sh gratë, të rinjtë etj.). Një fokusgrup rekomandohet të mbahet me një grup nga minimum 8 deri në 15 pjesëmarrës. Lehtësuesi prezanton kontektin në të cilin organizohet fokusgrupi, qëllimin e tij dhe mënyrën si do të përdoren të dhënat e gjeneruara përmes fokusgrupit. Më pas ai lehtëson diskutimin në grup duke treguar kujdes që të mos e drejtojë bisedën dhe të përfshijë sa më shumë pjesëmarrësit në diskutime. Hapat konkrete përfshijnë:

- Ftesa për pjesëmarrje të përfaqësuesve të nën-grupeve të nënpërfaqësuara në metodat e tjera të mbledhjes së të dhënave.
- Prezantimi i grupit me pyetje të gjashme me ato të matricës;
- Regjistrimi i të gjitha përgjigjeve në mënyrë anonime dhe dërgimi i tyre pranë ekspertëve përkatës.

### Analiza e rrjedhës së shkaqeve

Edhe kjo metodë mund të përdoret në grup të madh ose të zhvillohet një herë në grupe më të vegjël e më pas të dakordësohet në grup të madh. Lehtësuesi u kërkon pjesëmarrësve të diskutojnë dhe më pas vizatojnë diagrama të shkaqeve që çojnë në situata/probleme të caktuara. Ky ushtrim i shërben shumë mirë eksplorimit të perceptimeve të komunitetit mbi shkaqet e problemeve dhe arsyet përse ato vijojnë.

Pema e problemit është një teknikë që mund ta lehtësojë këtë proces. Në të paraqiten në mënyrë vizuale dhe të përmbledhur shkaqet e problemit – tek rrënjët e pemës; problemi që po analizohet – në trung; pasojat ose efektet e tij – tek gjethet dhe frytet e pemës.




*Figura 6. Pema e problemit.*

## Matrica e problematikave dhe adresimi i tyre

Ndërtimi i matricës së aktorëve është një ushtrim që mund të përdoret si me anëtarët e komunitetit ashtu edhe në takimet me përfaqësues të institucioneve. Ajo synon evidentimin e çështjeve kryesore për çdo fushë interesi, të prekurit prej problematikës/çështjes, nevojat specifike që ka komuniteti i synuar në lidhje me të, pengesat që hasen, aktorët përgjegjës dhe mundësisë për adresimin e problematikës/nevojës.

Ushtrimi mund të lehtësohet nga lehtësuesi vendor me gjithë grupin e madh ose mund të realizohet në grupe të vogla para se të dakordësohet në grupin e madh. Në variantin e dytë, lehtësuesi kërkon që grupi të ndahet në disa grupe te vogla (mund të sugjerohet të ndahen sipas interesave ose asaj që përfaqësojnë në takim) dhe secili grup cakton një lehtësues dhe prezantues për punën. Në fund të procesit secili grup përmbledh diskutimet e tij në një tabak letre me një tabelë si ajo që ilustrohet më poshtë.

Lehtësuesi kryesor, pasi dëgjon prezantimet e tabelave nga secili grup i vogël, i kërkon grupit të madh të diskutojnë mbi to dhe dakordësojnë një tabelë përmbledhëse të aprovuar si përfundimtare nga i gjithë grupi. Ky proces ndihmon që të ndërtohet një konsensus lidhur me të gjithë elementët që përmban tabela.

Tabela 2. Model për matricën e problemeve kryesore dhe zgjidhjen e tyre.

| Fusha | Cilat janë çështjet kryesore? | Kush preket? | Cilat janë nevojat/kërkesat e komunitetit rom? | Çfarë pengesa hasin? | Kush është përgjegjës? | Çfarë propozime kemi? |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| Arsimi | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| Shëndeti | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| Etj. | | | | | | |
| | | | | | | |

**Matrica (Renditje dhe pikëzim)**

Matrica si ato të prodhura në seksionin pararendës mund të përdoren edhe për prioritizimin e problematikave dhe ndërhyrjeve të propozuara. Kështu, përmes një procesi të rrahjes së mendimeve (brainstorming) mund të listohen fillimisht të gjitha problemet dhe nevojat. Në mënyrë të ngjashme mund të listohen të gjitha propozimet për zgjidhje. Më pas, lehtësuesi përmes një sistemi pikëzimi u kërkon pjesëmarrësve që secilës problematikë dhe secilës zgjidhje t'u vendosen pikë sipas rëndësisë/prioritetit që kanë. Çdo pjesëmmarrës ka të drejtën e votimit me pikët e tij/saj individuale. Totali në fund do të përcaktojë edhe renditjen e problemeve dhe zgjidhjeve për prioritare dhe më të inkurajuara, respektivisht.

## IX.2 Pyetësori për vlerësimin e kapaciteteve të Bashkisë

Përkundrejt nevojave të identifikuara për minoritetet R&E, nevojitet të vlerësojmë edhe nivelin e kapaciteteve që bashkitë me të cilat po punojmë kanë në raport me secilën fushë interesi. Për organizimin e të dhënave lidhur me këtë vlerësim na vjen në ndihmë modeli i Doracakut ROMACTED. Më poshtë paraqiten fushat e vlerësimit të kapaciteteve të bashkisë dhe pyetjet orientuese për secilin komponent.

Tabela 4. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e arsimit (përfshirë sistemin parashkollor)

| | | | |
|---|---|---|---|
| **ARSIMI** | **A ka kryer bashkia ndonjë projekt përmirësimi infrastrukturor në 3 vitet e fundit?** | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po, a ishte ndonjë prej tyre me numër të konsiderueshëm fëmijësh rom?* | Po/Jo | |
| | *Nëse po, a ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | A ka kryer bashkia ndonjë trajnim për mësues në 3 vitet e fundit? (p.sh në bashkëpunim me DARin etj.) | Po/Jo | |
| | *Nëse po, a ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | A ka ndërmjetësues shkollorë aktivë në komunitetet rome? | Jepni një shifër | |
| | A financon bashkia ndonjë program tjetër mbështetjeje për fëmijët rom? | Po/Jo | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të lidhura me arsimin të adresohen në nivel vendor? | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e arsimit? | Kapacitet i latë/ mesatar/i ulët | |
| | Cili është fondi i investimit i miratuar për ndërtim të kopshteve të rinj dhe/ose rindërtim të kopshteve ekzistues në raport me buxhetin vendor për vitin e raportimit (në %) | _% | |
| | Referuar pyetjes me lart, a ka patur kopshte/ çerdhe, që frekuentohen nga femijë të komunitetit rom? | v.2019 (parashikimi në PBA) | |
| | Fondi i investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe/ose rikonstruksionin e shkollave ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin e raportimit (në %) | __% | |
| | Referuar pyetjes më lart, a ka patur shkolla të mirëmbajtura/ose rindërtuara që frekuentohen nga një numër i konsiderueshëm fëmijësh të komunitetit rom? | | |
| | Çështje të tjera | | |

*Tabela 5. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e punësimit*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **PUNËSIMI** | **A ka kryer bashkia ndonjë projekt që synon përmirësimin e aftësive dhe punësimin në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nese po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |

| | | |
|---|---|---|
| Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse në këtë fushë? | Listojini ato | |
| A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | Po/Jo | |
| A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në pushën e punësimit? | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |
| A ka mbështetur Bashkia të rinj rom për arsim dhe trajnim profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës (në bashkëpunim me DARin dhe Zyrën e Punës)? Sa? | Po/Jo<br><br>Numër (të përafërt) | |
| A ka të papunë R/E që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional? Sa? | Po/Jo<br><br>Numër (të përafërt) | |
| Çështje të tjera  me rëndësi për t'u shënuar? | Shëno | |

*Tabela 6. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e strehimit*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **STREHIMI** | **A ka zbatuar bashkia ndonjë projekt në fushën e strehimit në 3 vitet e fundit?**<br><br>**A ishte ndonjë prej tyre i fokusuar për familjet/komunitetin rom?** | | **Po/Jo**<br>**Sa?**_________<br><br>**Po/Jo**<br>**Sa?** _________ | |
| | *Nëse po:* | *A u aplikua për fonde?* | Po/Jo | |
| | | *A mori fonde nga BE?* | Po/Jo | |
| | | *Po nga donatorë të tjerë?* | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse në këtë fushë? | | Listojini ato | |

| | | |
|---|---|---|
| A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | Po/Jo | |
| A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e strehimit? | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |
| Përqindja (%) e rasteve të strehimit social per komunitetin rom | | |
| Çështje të tjera me rëndësi për t'u shënuar? | Shëno | |

*Tabela 7. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e kujdesit shëndetësor*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **KUJDESI SHËNDETËSOR** | **A ka zbatuar bashkia ndonjë projekt për kujdesin shëndetësor në/për komunitetin ro në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |
| | Sa ndërmjetësues të kujdesit shëndetësor janë aktivë në komunitetet rome? | | Jepni një numër | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e kujdesit shën-detësor? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |

*Tabela 8. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e barazisë dhe përfshirjes sociale*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **PËRFSHIRJA** | **A ka zbatar bashkia ndonjë projekt për promovimin e barazisë dhe përfshirjes sociale në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që cështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte për përfshirjen sociale? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |

Tabela e fundit targeton një çështje ndërsektorale dhe ndërtematike, atë të financimit dhe ngritjes së fondeve për financimin e projekteve të ndryshme. Në këtë seksion në mënyrë specifike do të vlerësohen dhe jepen sa me shumë informacione dhe të dhëna mbi kapacitetet dhe mundësitë që ka bashkia e targetuar për shkrim projektesh, ngritje fondesh dhe zbatim të projekteve të financuar nga fonde të BE-së, fonde të donatorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë etj.

*Tabela 9. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën shkrimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **FINANCIMI** | **A ka bashkia kapacitete të aplikojë dhe përdorë fonde të BE-së apo donatorëve të tjerë, përfshirë fonde kombëtare?** | **Kapacitet i latë/ mesatar/i ulët** | |
| | A mundet bashkia të aplikojë për fonde të donatorëve të tjerë (SDC/Zvicerane, EEA/Norvegjeze apo të tjera si rojekte Nderkufitare IPA, ADRION, MED, BALLKAN-MEDITERRAN)? | Po/Jo | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | Listojini ato | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | A ka mbështetur Bashkia me grante OSHC që promovojnë integrimin social-ekonomik të komunitetit rom? | | |
| | Çështje të tjera me rëndësi për t'u shënuar? | Shëno | |

*Rritja e transparencës në nivel vendor:* Numri i rekomandimeve të anëtarëve të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, OSHC të reflektuara në dokumentin e PBAsë/buxhetit kundrejt numrit të përgjithshëm të rekomandimeve nga ky komunitet/ose grup interesi. Më konkretisht pyetjet që do duhet të adresohen në këtë drejtim janë:

- A kanë dhënë rekomandime pakicat rome dhe egjiptiane ose organizata të shoqërisë civile që mbështetin këto pakica në procesin e konsultimit të buxhetit vjetor ose PBAsë?
- Nëse po, sa rekomandime janë reflektuar në vitin 2018?

*Aspekte të tjera të vlerësimit të kapaciteteve të Bashkisë dhe institucioneve të tjera në nivel vendor*

Tabela e fundit mbledh informacion lidhur me disa aspekte të tjera të vlerësimit të kapaciteteve të bashkive dhe institucioneve të tjera në nivel vendor.

*Tabela 10. Aspekte të tjera të vlerësimit të kapaciteteve të Bashkisë dhe institucioneve të tjera në nivel vendor*

| | **Burime Njerëzore / Zhvillim të Kapaciteteve** | **Po** | **Jo** | **Shpjegime** |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Nëse keni përshkrim pune, përcaktohen qartë roli dhe detyrat e gjithsecilit sipas pozicionit të punës? Është përshkrimi i punës i plotësuar sipas një modeli/formati të caktuar (p.sh modeli i miratuar nga DAP)? | | | |
| **2** | A ka sistem komunikimi efektiv lidhur me zgjidhjen e problemeve, kryerjen e detyrave/ funksioneve në Këshillin Bashkiak dhe/ose titullarin e institucionit? | | | |
| **3** | A ka komunikim dhe/ose pjesëmarrje të rregullt të pikave fokale për romët dhe egjiptianët në takimet e përbashkëta dhe të rregullta të Këshillit Bashkiak dhe/ose në institucionet e tjera (të cilat janë përgjegjëse për dhënien e shërbimeve publike për probleme specifike dhe që shqetësojnë komunitetin)? | | | |
| **4** | A keni akses të mjaftueshëm në zhvillimin e aftësive (trajnimeve) për të kryer punën (shërbimin që ofroni) me cilësi? | | | |
| **5** | Sa nëpunës janë trajnuar gjatë 2 viteve të fundit? Jepni fushat kryesore. | | | |
| **6** | A keni aftësi të mjaftueshme për të kryer rolin tuaj në shërbimin publik të institucionit që i përkisni? | | | |
| **7** | Jepni deri në tre drejtime në të cilat keni nevojë për rritje të aftësive në të ardhmen: | | | |
| **8** | Cilat janë tre (3) përmirësimet më të rëndësishme lidhur me ofrimin e shërbimeve të bashkisë në dy vitet fundit? | | | |
| **9** | Çfarë mbeten tre (3) dobësitë më kritike lidhur me dhënien e shërbimeve në bashkinë tuaj? | | | |

## IX.3 Task Forca Bashkiake Korçë

| Grupi Institucional i Punës (GIP) |
|---|
| 1. Benila Terova - Nënkryetare |
| 2. Ilir Zguri – Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social |
| 3. Manjola Teme - Specialiste, Drejtoria e Kujdesit Social |
| 4. Valbona Ziko - Drejtore, Drejtoria e Financave |
| 5. Denada Tabaku - Koordinatore, Drejtoria e Financave |
| 6. Mariana Jorgji - Shërbimi Social Shtetëror |

| Grupi Komunitar i Veprimit (GKV) |
|---|
| 1. Etleva Tare – GKV Korçë |
| 2. Arben Kosturi- GKV Korçë |
| 3. Esmeralda Duro - GKV Korçë |
| 4. Egla Lubonja - GKV Korçë |
| 5. Polina Sula - GKV Korçë |

## IX.4 Vendim i Këshillit Bashkiak Korçë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 47** **dt. 28.05.2020**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË INTEGRIMIT TË PAKICAVE ROME/EGJIPTIANE PËR BASHKINË KORÇË.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, mbështetur në:
*Ligjin Nr. 139/2015*.datë,17/12/2015 « *PËR* VETËQEVERISJEN *VENDORE* », Ligjin Nr. 68/2017 « PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE », *Ligjin* Nr. 96/2017. « *PËR MBROJTJEN E PAKICAVE* KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË »,*Ligjin* Nr. *22/2018*. « *PËR STREHIMIN SOCIAL* », Vendimin Nr.08, Datë 09.02. 2018 të Këshillit Bashkiak Korçë, « Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për zbatimin e Programit "ROMACTED" në Bashkinë Korçë", mbasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ana e lehtësueses së projektit e kontraktuar nga Këshilli i Europës dhe Drejtoria e Kujdesit Social,

**VENDOSI :**

1- Të miratojë Planin Vendor të Integrimit të Pakicave Rome/Egjiptiane për Bashkinë Korçë .
2- Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria e Hartimit dhe implementimit te projekteve në Bashki, Administrata e Bashkisë etj.
3- Ky Vendim hyn në fuqi 10-ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
**Eva Naçi**

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
**Erjon Nexhipi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... KORÇË

Adresa: Kodi Postar 7001, Lagji 12, Blv "Shen Gjergji", nr. 12, Tel : +35582243353, email:info@bashkiakorce.gov.al

# ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

www.europa.eu


Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës